

UDHËZIM
Nr.17, datë 22.5.2009

**PËR MBLEDHJEN, ADMINISTRIMIN DHE PUBLIKIMIN E INFORMACIONIT PËR
PROCESIN E NUMËRIMIT TË VOTAVE PËR ZGJEDHJET E KUVENDIT TË
SHQIPËRISË, 2009**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 21, pika 1, nenit 119, pika 2 dhe nenit 122, pika 3 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

UDHËZON

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë procedurat që do të zbatohen KZAZ-ja dhe KQZ-ja për mbledhjen, administrimin dhe publikimin e informacionit për procesin e numërimit të votave për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë, 2009.

Neni 2
Informacioni që do të japë KZAZ-ja

Pas mbylljes së votimit, KZAZ-ja duhet të dërgojë në KQZ informacionin për:

- a) Rregullsinë e kutive të fletëve të votimit dhe kutive me materialet e votimit të marra në dorëzim nga KQV-të;
- b) Rezultatet e zgjedhjeve të çdo QV-je për partitë politike dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit në mënyrën e përcaktuar në këtë udhëzim.
- c) Miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor përkatës.

Neni 3
Përmbajtja e informacionit për rezultatet e zgjedhjeve

- 1. Informacioni për procesin e numërimit të votave mbështetet në tabelat e rezultateve të plotësuara nga grupet e numërimit dhe të dorëzuara në KZAZ.
- 2. Informacioni duhet të përmbajë domosdoshmërisht për çdo QV:
 - a) Numrin e fletëve të votimit të papërdorura;
 - b) Numrin e fletëve të votimit të dëmtuara;
 - c) Numrin e fletëve të votimit të gjetura në kutinë e votimit;
 - d) Numrin e votave të pavlefshme;
 - e) Numrin e votave të vlefshme;
 - f) Shpërndarjen e votave të vlefshme për partitë politike dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit.

Neni 4
Përgjegjësia për përcjelljen e informacionit në KQZ

Përcjellja e informacionit të përcaktuar në këtë udhëzim, në KQZ, bëhet nën drejtimin dhe përgjegjësinë e sekretarit të KZAZ-së.

Neni 5

Mënyra e dhënies së informacionit për rezultatet nga KZAZ-ja në KQZ

1. KZAZ-ja përcjell në rrugë elektronike në KQZ, për çdo QV, informacionin e përcaktuar në pikën “a” të nenit 2 të këtij udhëzimi, menjëherë pas marrjes në dorëzim nga KZAZ-ja të kutive të fletëve të votimit dhe kutive me materialet e votimit nga të gjitha KQV-të.

2. KZAZ-ja përcjell në rrugë elektronike në KQZ, për çdo QV, informacionin e përcaktuar në pikën “b” të nenit 2 të këtij udhëzimi, menjëherë pas marrjes së tabelës së rezultateve nga GN-ja. Ky proces vazhdon deri në përfundimin e vlerësimit të numërimit të votave dhe dorëzimit të të gjitha tabelave të rezultateve prej GN-ve sipas kësaj mënyre:

a) Sekretari i KZAZ-së, pasi GN-ja i dorëzon tabelën e rezultateve të një QV-je, ia jep atë operatorit të hedhjes së të dhënave. Operatori i hedh të dhënat e tabelës së rezultateve në aplikimin elektronik në kompjuter dhe printon në letër informacionin që ka në formë elektronike. Në momentin e printimit aplikimi elektronik automatikisht bëhet i pa editueshëm/i pa shkrueshëm.

b) Tabela e printuar nga forma elektronike i dorëzohet GN-së nga sekretari i KZAZ-së, për të verifikuar vërtetësinë e të dhënave.

b.1 Në rast se informacioni në tabelën e rezultateve të plotësuar me shkrim dore dhe ai i printuar nga sistemi elektronik janë të njëjta, sekretari i KZAZ-së udhëzon operatorin të dërgojë në rrugë elektronike rezultatet drejt KQZ.

b.2 Në rast se informacioni në tabelën e rezultateve të plotësuar me shkrim dore dhe ai i printuar nga sistemi elektronik janë të ndryshme, numëruesi i parë i GN-së bën korrigjimet me shkrim dore në fletën e printuar dhe kjo fletë firmoset nga anëtarët e GN-së. Sekretari i KZAZ-së kthen aplikimin elektronik në të editueshëm/të shkrueshëm dhe udhëzon operatorin të bëjë korrigjimin e të dhënave të pasakta dhe përsëritet procedura e printimit, verifikimit dhe dërgimit në KQZ.

3. Format i printuar dhe tabela origjinale e rezultateve i bashkëngjiten njëra-tjetrës dhe shërbejnë si dokumentacion zyrtar që i dorëzohet KQZ-së.

4. Pas përfundimit të procesit të numërimit të të gjitha QV-ve dhe miratimit nga KZAZ-ja i tabelës përmbledhëse të rezultateve për ZAZ-në përkatëse, sekretari i KZAZ-së udhëzon operatorin të dërgojë në rrugë elektronike, në KQZ, konfirmimin e miratimit.

Neni 6

Publikimi i informacionit lidhur me procesin e numërimit të votave

Me marrjen e informacionit nga KZAZ-të, KQZ-ja bën publikimin në dinamikë të rezultateve në rang zone zgjedhore/qarku.

Publikimi i informacionit të mësipërm bëhet në monitorët e sallës së mediave, në faqen e KQZ-së në internet dhe printohet në letër.

Informacioni do të jepet në numër votash të vlefshme të fituara dhe përqindje përkatëse për koalicionet, partitë dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit.

Neni 7

Informacioni i publikuar nga KQZ-ja, në çdo rast, shoqërohet me numrin gjithsej të QV-ve në zonën përkatëse zgjedhore dhe me numrin e QV-ve mbi të cilin është llogaritur rezultati i dhënë.

Neni 8

Informacioni i publikuar sipas këtij udhëzimi nuk përbën rezultat zyrtar.

Neni 9

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Arben Ristani